



**Clingendael**

Netherlands Institute of International Relations

**epik.**

**Dritë në fund të tunelit?**  
Qëndrimi holandez për procesin  
e liberalizimit të vizave për Kosovën

# Dritë në fund të tunelit? Qëndrimi holandez për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën

Wouter Zweers, Luc Köbben (Instituti Clingendael), Arben Kalaja, Demush Shasha (Instituti EPIK)

## Abstrakt

Kosova mbetet vendi i fundit në Ballkanin Perëndimor që ende nuk përfiton nga liberalizimi i vizave me BE-në. Liberalizmi i vizave do të lejonte qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm brenda zonës Shengen deri në 90 ditë. Përkundër vlerësimit pozitiv të vitit 2018 nga ana e Komisionit Evropian për përmbushjen e kritereve të udhërrëfyesit Holanda, si dhe disa vende të tjera anëtare të BE-së, kanë vazhduar të kundërshtojnë propozimin për liberalizimin e vizave, duke përmendur shqetësimet për mungesën e progresit në fushën e sundimit të ligjit. Status quo-ja ka rezultuar në një politizim të procesit dhe rritje të frustrimeve. Analizimi i pozicioneve të kundërta të palëve është thelbësor në mënyrë që të identifikohet rruga përpara e cila do të lejonte daljen nga bllokada momentale, si nga pala holandeze ashtu edhe nga ajo kosovare. Prandaj, ky dokument tenton të ofrojë një vlerësim të pozicionit holandez për procesin e liberalizimit të vizave, si dhe perceptimin e pozicionit holandez në Kosovë. Ai e bën këtë përmes një analize të dokumenteve qeveritare dhe intervistave me politikë-bërës, politikanë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Hulumtimi ynë ka konkluduar se pozicioni Holandez është dalëngadalë duke ndryshuar, edhe pse ende ekzistojnë dallimet në mes palëve. Ky ndryshim qëndrimi holandez mund të kontribuoj në liberalizimin e vizave për Kosovën nga fundit i vitit 2022. Po ashtu, hulumtimi ynë ofron rekomandime për Kosovën dhe Holandën me qëllim të avancimit të procesit të liberalizimit të vizave.

## Hyrja

Kur Komisioni Evropian propozoi dhënien e liberalizimit të vizave për Kosovën në vitin 2018, Këshilli i BE-së (në tekstin e mëtejme 'Këshilli') nuk arriti të pajtohej për këtë çështje. Ndërsa zyrtarisht vendimi merret me votim të shumicës së cilësuar, procesi i vendimmarrjes asnjëherë nuk ka arritur deri aty. Në mesin e vendeve të tjera të BE-së, Holanda, Franca dhe Gjermania shprehën shqetësime për mungesën e progresit të Kosovës, veçanërisht në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar. Që atëherë Kosova, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian kanë bërë thirrje Këshillit që të merr vendimin për liberalizimin e vizave, ndërsa Holanda në veçanti ka vazhduar të shprehë shqetësime.<sup>1</sup> Ky ngërç ka çuar në një politizim të procesit dhe, nga ana tjetër, në rritje të frustrimeve në Kosovë.<sup>2</sup>

Praktikisht, status quo-ja do të thotë se 1.9 milionë qytetarë të Kosovës janë të vetmit qytetarë të Ballkanit Perëndimor që nuk mund të udhëtojnë lirshëm drejt BE-së për një periudhë 90-ditore – përveç nëse kanë shtetësi shqiptare ose një shtetësi tjetër të dytë. Ndryshe nga qytetarët për shembull të Serbisë apo Malit të Zi, qytetarët e Kosovës duhet të kalojnë nëpër një procedurë komplekse aplikimi për vizë, e cila ndër të tjera kërkon që ata të dorëzojnë informacione personale për të ardhurat dhe pasurinë – dhe në fund fare, epilogu i procesit të aplikimit është i paqartë. Për qytetarët e Kosovës, kjo situatë sforcon ndjenjën e të qenurit qytetarë të rangut dytë, duke pasur parasysh po ashtu se jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së e njohin Kosovën si shtet të pavarur.

Ky ngërç ka shkaktuar lindjen e dy narracioneve konkurruese mbi procesin e liberalizimit të vizave. Në Kosovë, pozicioni i Holandës ka shkaktuar frustrim ndaj Hagës, pasi që Holanda me një anë ka ngritur shqetësime për mos përmbushjen e kriterëve të liberalizimit të vizave, por nga ana tjetër ka refuzuar të angazhohet dhe të specifikoj qartë se çfarë do të konsideronte ajo përmbushjen e plotë të kriterëve të liberalizimit të vizave. Një qasje e tillë ka ngritur dyshime në Kosovë se pozicioni i Hagës po ndikohet nga motivet e brendshme politike dhe frika nga shtimi i migrimit. Zyrtarët kosovarë nuk arrijnë të kuptojnë se çfarë saktësisht duhet bërë për të zgjidhur shqetësimet holandeze. Nga ana tjetër, Holanda ka vazhduar të theksojë se liberalizimi i vizave është një proces i udhëhequr nga BE-ja dhe rrjedhimisht nuk duhet trajtuar në nivel bilateral në mes Kosovës dhe Holandës, por në mes Kosovës dhe BE-së. Po ashtu, zyrtarët në Hagë e kanë vështirë të kuptojnë vëmendjen kosovare karshi Holandës, pasi që Holanda nuk ka qenë asnjëherë i vetmi vend që ka ngritur shqetësime për mos përmbushjen e kriterëve të liberalizimit të vizave, por këtë e ka bërë në koordinim me disa vende të tjera anëtarë të BE-së.

Duke marrë parasysh ngecjen aktuale, politizimin e procesit dhe frustrimet në rritje, ekziston nevoja për një kuptim të qartë dhe të detajuar të narrativeve të ndryshme të cilat ekzistojnë në Holandë dhe Kosovë. Analizimi i pozicioneve të kundërta është thelbësor në mënyrë që të identifikohet rruga përpara e cila do të lejonte daljen nga bllokada momentale, si nga pala holandeze ashtu edhe nga ajo kosovare. Gjetja e një zgjidhjeje konstruktive është në interes

<sup>1</sup> Arlinda Kqiku dhe Arbësa Ibrahim, "[Qëndrimi i Holandës, i Sllovakisë dhe i Bullgarisë për vizat](#)", *Zëri*, korrik 11, 2019; "[42 MEPs Ask Macron & Rutte to Support Visa Liberalisation for Kosovo](#)", *Schengen news*, korrik 9, 2020; "[Netherlands Continues to Oppose Kosovo's Visa Liberalisation Due to Corruption](#)", *Schengen news*, maj 19, 2021

<sup>2</sup> Aleksandar Ivković, "[What is holding Kosovo's visa liberalisation back?](#)", *European Western Balkans*, dhjetor 26, 2018; Gentiola Madhi, 'Diluting Principles, Darkening EU Accession Perspective: Politicization of Kosovo's Visa Liberalization Process' në Armakolas et al (eds.), *Local and International Determinants of Kosovo's Statehood* (2021), KFOS: 301-334; Zoran Nechev dhe Donika Emiri, "[Visa Liberalisation: Kosovo's Saga on the EU Path](#)", *Kosovo Foundation for Open Society*, janar 2022.

të Holandës, pasi që status quo-ja për liberalizimin e vizave pengon integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE, gjë që ndikon negativisht në stabilitetin politik dhe përpjekjet për demokratizim, duke minuar kështu besueshmërinë dhe kredibilitetin e BE-së. Prandaj, ky hulumtim tenton të vlerësoj pozicionin holandez dhe atë kosovar karshi liberalizimit të vizave duke analizuar dokumente zyrtare, si dhe duke përmbledhur vlerësimet e politike-bërësve, politikanëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Dokumenti analizon pozicionin holandez nga viti 2018 e deri më sot, përshkruan progresin në reformat e sundimit të ligjit në Kosovë dhe më pas diskuton perspektivën e Kosovës karshi pozicionit holandez. Hulumtimi përfundon me rekomandime konkrete për të dyja palët.

## Pozicioni holandez në vitin 2018

Kur Komisioni Evropian propozoi liberalizimin e vizave në vitin 2018, Holanda dhe disa shtete të tjera anëtare të BE-së nuk ishin të bindura se Kosova kishte bërë përparim të mjaftueshëm në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar. Ky ishte një nga dy kriteret e mbetura të cilat Komisioni Evropian i kishte vlerësuar si të përmbushura. Në atë kohë Kosova kishte raportuar se kishte identifikuar 42 raste në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar. Nga këto 33 kishin përfunduar me aktakuzë, 5 kishin përfunduar me dënime të formës së prerë dhe 9 persona ishin dënuar.<sup>3</sup> Ndërsa Komisioni e quajti këtë 'progres të qëndrueshëm' në krahasim me raportin e tij të vitit 2016, politikë-bërësit holandezë ishin të shqetësuar për rastet që po pushoheshin në fazën paragjyqësore dhe numrin e ulët të dënimeve përfundimtare, kapacitetin e përgjithshëm institucional të sundimit të ligjit në Kosovë, si dhe mungesën e vullnetit politik për avancimin e luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar. Si i tillë, qëndrimi holandez për liberalizimin e vizave ishte në përputhje me parimin tradicional të politikës Holandeze karshi zgjerimit: "strikt, por fer".

Holanda ka pasur kritika edhe për Komisionin Evropian, raportimin e të cilit e konsideroi të pamjaftueshëm.<sup>4</sup> Së bashku me disa vende anëtare të BE-së, Holanda kërkoj Komisionit elaborim të mëtejshëm për mënyrën e vlerësimit të tyre për përmbushjen e tërësishme të kriterëve të liberalizimit të vizave nga ana e Kosovës. Sipas politikë-bërësve holandezë, Komisioni asnjëherë nuk ofroj informata shtesë. Hendeku në mes vlerësimeve të Komisionit dhe Holandës ka ndodhur po ashtu sepse Holanda ka ngritur mekanizmat e saja të monitorimit përmes 'rrjetit për sundimin e ligjit' i cili funksionon pranë pesë ambasadave të saja në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë edhe Kosovën.<sup>5</sup>

Që nga viti 2018, Holanda ka vazhduar të kërkojë progres në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar, dhe njëkohësisht ka nënvizuar se nuk duhet të këtë degradim në zbatimin e kriterëve të tjera të liberalizimit të vizave.<sup>6</sup> Që nga ajo kohë tema e liberalizimit të vizave për Kosovën asnjëherë nuk është vendosur në rend dite të Këshillit nga asnjë vend anëtar i BE-së. Ndryshe nga Gjermania dhe Franca, Holanda është treguar skeptike për ngritjen e dialogut bilateral me Kosovën për diskutimin e procesit të liberalizimit të vizave, pasi që ajo e konsideron këtë proces nën kompetencat të BE-së dhe rrjedhimisht duhet mbetur në nivelin Kosovë – BE. Rrjedhimisht strategjia e Kosovës për të lobuar tek shtetet anëtare individuale ka qenë e padobishme karshi Holandës.<sup>7</sup>

<sup>3</sup> Komisioni Evropian, "[Update on the implementation of the remaining benchmarks of the visa liberalisation roadmap by Kosovo](#)", 543 final, korrik 18, 2018: 4.

<sup>4</sup> Kamerstuk 21501-02, nr. 1939, "[Verslag van de Raad Buitenlandse Zaken van 10 december 2018](#)", dhjetor 12, 2018: 3.

<sup>5</sup> "[Rule of Law Regional Network](#)", Mbretëria e Holandës.

<sup>6</sup> Kamerstuk 23987, nr. 361, "[Kabinetsappreciatie uitbreidingspakket 2019](#)", qershor 5, 2019: 7-8.

<sup>7</sup> "[Minister Hardinaj Stubbla was received by her counterpart in the Hague, whereby inviting the Netherlands to reconsider its sceptical position towards the issue of visa liberalisation for Kosovo, at the same time they signed the Social Security Agreement between the two countries](#)", *Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës*, shtator 17, 2020; "Verzoek [Kosovo inzake visuliberalisatie proces](#)", tetor 31, 2018.

## Pozicioni i Holandës po ndryshon...

Qeveria holandeze e konsideron liberalizimin e vizave si "një instrument efektiv për të nxitur reformat...", me theks të veçantë në fushën e sundimit të ligjit.<sup>8</sup> Lufta kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar është indikator i rëndësishëm për progresin në fushën e sundimit të ligjit.<sup>9</sup> Rrjedhimisht, zhvillimet pozitive në këtë drejtim mund të ndryshojnë pozicionin e Holandës. Pavarësisht paqartësisë se çfarë saktësisht duhet të sjellin zhvillime të tilla pozitive, ngjarjet e ndryshme të fundit janë shkak për optimizëm të kujdesshëm. Në nëntor 2021, qeveria holandeze i vlerësoi si premtuese muajt e parë të Qeverisë Kurti II.<sup>10</sup> Politikë-bërësit holandezë kanë deklaruar se shumica e madhe e Kurtit në parlament premtton stabilitetin shumë të nevojshëm politik që ofron një mundësi për zbatimin e reformave dhe luftimin e korrupsionit. Ndërkohë, kjo çështje ka tërhequr vëmendjen edhe të mediave holandeze.<sup>11</sup>

Në këtë sfond, pak para samitit të Këshillit Evropian në qershor 2022, parlamenti holandez miratoi një mocion nga deputetja Kati Piri (PvdA) për të rishqyrtuar liberalizimin e vizave për Kosovën në një afat të shkurtër në bazë të një opinioni të ri të Komisionit.<sup>12</sup> Po ashtu gjatë samitit delegacioni holandez siguroi zotimin nga Komisioni Evropian për të përgatitur një raport të përditësuar për përmbushjen e standardeve të liberalizimit të vizave nga Kosova, i cili do të publikohet në tetor të vitit 2022.<sup>13</sup> Për më tepër në samit Kryeministri Mark Rutte tha për mediat si në vijim:

*[...]Ndoshta edhe për liberalizimin e vizave për Kosovën mund të shpresojmë që më vonë këtë vit ose vitin e ardhshëm mund të bëjmë hapin e radhës, sepse ata kanë bërë shumë punë drejt fuqizimit të sundimit të ligjit dhe ngritjes së gjyqësorit të pavarur".<sup>14</sup>*

Deklarata e Rutte në samit, ku ai i referohet dhënies së liberalizimit të vizave si "hap i radhës", ishte domethënëse sepse ishte hera e parë që një zyrtar holandez tregoi një ndryshim të mundshëm qëndrimi për procesin e liberalizimit të vizave të Kosovës. Këto zhvillime paralajmërojnë një pozicionim më të hapur dhe më pozitiv të Holandës karshi liberalizimit të vizave.

<sup>8</sup> Kamerstuk 2022Zo8821, "[Kabinetsappreciatie van Europese Commissie rapporten inzake visumliberalisatie en het noodremmechanisme](#)", maj 6, 2022: 2.

<sup>9</sup> 'The progress on the targeted high-level cases in the track record offers a snapshot of the overall progress of the anti-corruption framework in Kosovo and offers insights in how the authorities tackle high-level organised crime and corruption.' Shiko raportin e Komisionit Evropian, "[Update on the implementation of the remaining benchmarks of the visa liberalisation roadmap by Kosovo, as outlined in the fourth report on progress of 4 May 2016](#)", COM(2018) 543 final: 3.

<sup>10</sup> Kamerstuk 23987, nr. 391, "[Kabinetsappreciatie uitbreidingspakket 2021](#)": 7.

<sup>11</sup> Thijs Reuten, Stefan van Dijk, "[Steun democratisch Kosovo en hef die zinloze reisblokkade op](#)", *Trouw*, prill 1, 2022; Marjolein Koster, "[Kosovaren willen zonder visum door de EU reizen en zijn het wachten beu](#)", *Nederlands Dagblad*, korrik 14, 2022.

<sup>12</sup> Kamerstuk 21501-20, nr. 1810, "[Motie van het lid Piri c.s.](#)", qershor, 22, 2022.

<sup>13</sup> Kamerstuk 21501-20, nr. 1824, "[Verslag van de Europese Raad, de Westelijke Balkantop en de Eurozonetop van 23 en 24 juni 2022](#)", korrik, 4, 2022.

<sup>14</sup> Këshilli Evropian, "[Arrival and doorstep Rutte \(NL\) - Part 2](#)", qershor 23, 2022 (nga minuta 2.00).

## ...Sidoqoftë disa sfida ende mbesin

Ende mbesin disa sfida para se mund të arrijmë në ndryshimin përfundimtar të pozicionit holandez. Së pari, Holanda mendon se progresi në fushën e sundimi të ligjit nuk duhet të jetë thjesht “sa për sy e faqe”, duke prezantuar disa numra abstrakt për progresin në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar. Në vend të kësaj, bisedat tona me politikë-bërësit holandez sugjerojnë që Haga shfajësohet liberalizimin e vizave si pjesë e një procesi kompleks i cili përfshin rregullimin e problemeve të thella në luftë kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit përmes reformës së sundimit të ligjit, dhe për këtë arsye lidhet drejtpërdrejt me stabilitetin institucional. Insistimi holandez në qëndrueshmërinë e reformave mund të nënkuptojë që reformat e ndërmarra duhet të tregohen të suksesshme përtej cikleve zgjedhore.

Së dyti, me gjithë qasjen teknike të qeverisë dhe fokusin në sundimin e ligjit, parlamenti holandez nga ana tjetër ka qenë më i shqetësuar me migrimin dhe krimin që mund të rritet si pasojë e liberalizimit të vizave brenda shtetit të Holandës. Gjatë një debati parlamentar të vitit 2019 për përfshirjen e qytetarëve shqiptarë në krimin e organizuar në Holandë, një mocion që i kërkonte qeverisë të kundërshtojë liberalizimin e vizave për Kosovën, pavarësisht nga çfarëdo progresi, nuk arriti të marrë shumicën, por megjithatë fitoi rreth një të tretën e votave të deputetëve.<sup>15</sup> Gjatë të njëjtit debat, parlamenti holandez miratoi mocionin për nisjen e procedurës së pezullimit të liberalizimit të vizave për Shqipërinë. Por përkundër miratimit në parlamentin holandez ky mocion nuk arriti të vejë në lëvizje institucionet e BE-së për të zbatuar pezullimin e liberalizimit të vizave për Shqipërinë. Duke pas parasysh se kjo kërkesë e parlamentit holandez nuk arriti të prodhojë çfarëdo efekti në Bruksel, atëherë kjo mund të krijojë një mjedis acarues brenda parlamentit holandez për shkak mospërfilljes së tij në çështjet që ndërlidhen me liberalizimin e vizave. Njëkohësisht, ky zhvillim ka minuar argumentin se vendet anëtare mund të ushtrojnë kontroll efektiv mbi liberalizimin e vizave përmes mekanizmit pezullues.

---

<sup>15</sup> Kamerstuk 2019D18263, “[Albanese bendes](#)”, prill, 11, 2019; Kamerstuk 29911, nr. 241, “[Motie van het lid Fritsma over geen visumvrijstelling voor Kosovo](#)”, prill, 11, 2019.

## Çfarë mund të pritët në të ardhmen e afërt?

Se fundmi kryeministri holandez Rutte siguroi parlamentin holandez se Holanda do të presë raportin e ardhshëm nga Komisioni Evropian para çfarëdo vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën.<sup>16</sup> Avancimet e rëndësishme në sundimin e ligjit mund ta shtyjnë qeverinë holandeze të japë një vlerësim më pozitiv në kuadër të 'kabinetsappreciatie'. 'Kabinetsappreciatie' është raport me shkrim me të cilin qeveria njofton parlamentin holandez për pozicionin e saj karshi çështjeve të ndryshme evropiane, në këtë rast karshi liberalizimit të vizave për Kosovën. Kjo mund të jetë pika fillestare për formalizimin përfundimtar të ndryshimit të pozicionit holandez.

Historia tregon se pozicioni holandez mund të ndryshoj gjithashtu nëse Holanda izolohet në qëndrimin e saj. Holanda abstenoj nga votimi kundër liberalizimit të vizave për Bosnje-Hercegovinën dhe Shqipërinë në vitin 2010, vetëm kur u bë e qartë se Franca kishte ndryshuar pozicionin e saj dhe për këtë arsye asnjë shtet tjetër anëtar nuk e kundërshtoi atë. Rrjedhimisht, Holanda u izolua dhe abstenoj nga votimi.<sup>17</sup> Aktualisht, mbetet e paqartë se cilat shtete të tjera anëtare mund të kundërshtojnë liberalizimin e vizave, mirëpo mbështetja e zëshme nga zyrtarët gjermanë sugjeron se janë shuar zërat kundërshtues brenda vendeve anëtare.<sup>18</sup> Pozicioni i Francës mund të jetë sërish kyç në këtë drejtim pasi që së bashku me Holandën ajo ka qenë ndër kritikët më të zëshëm të progresit në Kosovë. Është interesante se ambasadorja franceze në Kosovë së fundmi ka bërë deklaratë pozitive, ndonëse të formuluar me kujdes, për progresin e Kosovës që tregojnë se edhe qëndrimi francez po ndryshon.<sup>19</sup> Rrjedhimisht, ka një shans të konsiderueshëm që Kosovës t'i jepet liberalizimi i vizave deri në fund të vitit 2022.

Në këtë drejtim ajo që është e rëndësishme është se një shtet anëtar i BE-së, zakonisht ai që mban presidencën, do të duhet të vendosë në agjendën e Këshillit të BE-së çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. Është e qartë se Holanda nuk do ta shtyjë këtë pasi që nuk e konsideron si prioritet të saj politik. Presidenca Çeke nga ana tjetër ka treguar se zgjerimi është prioritet i presidencës së tyre të Këshillit dhe ambasadori çek në Kosovë ka treguar se vendi i tij do të shtyjë liberalizimin e vizave.<sup>20</sup> Mbetet për t'u parë, megjithatë, nëse kjo mbështetje deklarative do të përkthehet në akte praktike dhe vendosjen e liberalizimit të vizave për Kosovën në rendin e ditës, pasi shtetet e tjera anëtare kanë shtyrë këtë çështje në vitet e fundit pa ndërmarrë shumë veprime. Megjithatë, deklarata e Këshillit Evropian gjatë samitit në qershor të këtij viti për t'u rikthyer çështjes së liberalizimit të vizave

<sup>16</sup> "[Debat over de Europese top van 23 en 24 juni 2022](#)", qershor 22, 2022, stenogram: 56-57.

<sup>17</sup> Në vitin 2010, kur u propozua liberalizimi i vizave për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën, situata ngjasonte shumë me situatën e Kosovës në vitin 2018. Si francezët ashtu edhe holandezët ishin skeptikë, duke ngritur shqetësime në lidhje me progresin në luftë kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe migrimit. Megjithatë, pak para negociatave të Këshillit, francezët ndryshuan pozicionin, duke izoluar më pas holandezët në kundërshtimin e tyre. Ministri holandez për Migracionin dhe Azilin në atë kohë, Gerd Leers, përfundimisht abstenoj nga votimi kundër liberalizimit të vizave, duke dalë kështu kundër detyrës me të cilën u dërgua në Bruksel. Ai e bëri këtë sepse nuk donte t'i bënte dëm të panevojshëm pozicionit holandez në Bruksel, pasi ishte e qartë se do të kishte një shumicë të kualifikuar për liberalizimin e vizave. Shih Kamerstuk 2010D51945, "[Spoeddebat over de opheffing van de visumplicht voor Albanezen en Bosniërs](#)", dhjetor 15, 2010.

<sup>18</sup> "[German MFA Says Kosovo Has Done Its Part on Visa Liberalisation](#)", *Schengen news*, mars 14, 2022; "[Greek Foreign Minister in Kosovo, no word on recognition: Pro-visa liberalisation and dialogue with Serbia](#)", *Euronews Albania*, qershor 4, 2021.

<sup>19</sup> "[French ambassador gives positive signal for visa liberalization](#)", *RTK Live*, korrik, 15, 2022.

<sup>20</sup> Kosovapress, "[The Czech Presidency has the visa liberalization for Kosovo high on its agenda in the EU Council](#)", korrik 1, 2022.

në tetor 2022 është një tregues se Këshilli do të diskutoj liberalizimin e vizave për Kosovën gjatë pjesës së dytë të këtij viti.<sup>21</sup>

Në përmbledhje mund të konkludojmë se pozicioni holandez për liberalizimin e vizave ka qëndruar konsistent përgjatë viteve, duke vendosur në epiqendër të vet çështje teknike, para konsideratave politike. Rrjedhimisht, qeveria holandeze e konsideron liberalizimin e vizave jo një të drejtë politike, por një status i jashtëzakonshëm për vendet e treta, i cili mund të ofrohet vetëm nëse një vend përmbush kriteret e përcaktuara teknike. Prandaj, qëndrimi holandez është në përputhje me parimin tradicional holandez "strikt, por fer" në fushën e zgjerimit të BE-së, si dhe shqetësimeve sistematike që ajo shpreh për mbrojtjen e vlerave normative të BE-së, veçanërisht sundimit të ligjit.<sup>22</sup> Në këtë drejtim duket se për Holandën është tejet e rëndësishme që çdo avancim i Kosovës drejt liberalizimit të vizave të jetë në përputhje me këtë narracion holandez. Si e tillë, qeveria holandeze do të duhet të jetë në gjendje të arsyetoj çdo ndryshim pozicioni karshi liberalizimit të vizave për Kosovën në përputhje me këtë narracion politik në mënyrë që një ndryshim i tillë i pozicionit të jetë i pranueshëm brenda spektrit politik dhe social holandez.

## Reformat në Kosovë

Siç u theksua, Holanda në gjysmën e parë të vitit 2022 ka bërë disa vlerësime më pozitive për zbatimin e reformave në Kosovë. Deri në çfarë mase është i justifikuar një vlerësim i tillë? Kjo pjesë e hulumtimit analizon progresin në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë, me theks të veçante në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë.

Dështimi i BE-së për t'i dhënë Kosovës liberalizimin e vizave në vitin 2018 u pasua nga një periudhë e paqëndrueshmërisë politike në vend. Brenda katër viteve Kosova pati katër qeveri të ndryshme. Një mjedis i tillë i paqëndrueshëm politik dëmtoi përpjekjet për reformat thelbësore evropiane. Të pa kënaqur nga qeverisja e ish-mazhorancës, dhe të frustruar më tej nga sjellja e tyre gjatë pandemisë COVID-19, qytetarët votuan masivisht Vetëvendosjen gjatë zgjedhjeve të fundit të përgjithshme. Duke njohur disponimin qytetar, Vetëvendosje organizoi fushatën e saj elektorale nën sloganin 'Punë dhe Drejtësi'. Si rezultat, zgjedhjet e fundit të përgjithshme prodhuan një qeveri të re me legjitimitet të paprecedentë politik prej mbi 50% të mbështetjes për kryeministrin aktual, Albin Kurti. Kjo ka rezultuar për herë të parë në një Kuvend që ka një shumicë të rehatshme legjislative dhe një vullnet të fortë politik për të avancuar reformat evropiane. Që nga inaugurimi i saj, fokusi kryesor politik i qeverisë së re ka qenë sundimi i ligjit.

Në këtë sfond, qeveria e Kosovës ka nisur reformat thelbësore në fushën e sundimit të ligjit përmes tre iniciativave legjislative: ndryshimi i ligjit të Këshillit Prokurorial, "vetting" për gjyqtarët dhe prokurorët dhe ngritja e byrosë për konfiskimin e pasurisë së pajustificuar. Në vitin 2022 ka pasur një rritje të aktivitetit të policisë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, gjë që ka sjellë një rritje prej 85% të aktakuzave.<sup>23</sup> Për më tepër, përpjekjet e Kosovës në reformën e sundimit të ligjit janë njohur edhe nga monitoruesit ndërkombëtarë

<sup>21</sup> Kamerstuk 21501-20, nr. 1824, "[Verslag van de Europese Raad, de Westelijke Balkantop en de Eurozonetop van 23 en 24 juni 2022](#)", korrik, 4, 2022.

<sup>22</sup> Wouter Zweers and Iris van Loon, "[The Netherlands as a champion of EU enlargement?](#)", *Clingendael*, nëntor 2020.

<sup>23</sup> Raport i brendshëm i qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 5 maj 2022.



të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Kështu, Kosova ka arritur përmirësimin më të lartë vjetor në Indeks të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International dhe renditjen më të lartë ndonjëherë në raportin e fundit të Freedom House.<sup>24</sup> Po ashtu, vitin e kaluar qytetarët kosovarë përbënin numrin e dytë më të ulët të azilkërkuësve në BE në krahasim me vendet e tjera të rajonit.<sup>25</sup>

Si pjesë e zbatimit të kriterëve të liberalizimit të vizave Kosova në vitin 2015 krijoi një bazë të dhënave për të monitoruar rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimet të organizuar. Deri në vitin 2022, janë shënjuar 78 raste të tilla, 65 raste kanë përfunduar me aktakuzë, prej të cilave 23 kanë marrë vendim gjyqësor të formës së prerë. Nga këto vendime gjyqësore, 13 raste kanë përfunduar me vendime të pjesëshme fajësore, ku 21 persona janë dënuar për vepra të korrupsionit dhe 4 për krim të organizuar.<sup>26</sup>

Përkundër zhvillimeve pozitive të përshkuara më lart, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2021 thekson se *“Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje serioze dhe shqetësuese. Pavarësisht përpjekjeve të bëra, ekziston nevoja për vullnet të fortë dhe të vazhdueshëm politik për të trajtuar në mënyrë efektive rreziqet e korrupsionit sistematik, si dhe një përkushtim serioz i institucioneve penale për tu përgjigjur korrupsionit të nivelit të lartë.”*<sup>27</sup> Një pikë e vazhdueshme e kritikave nga ana e Komisionit Evropian është se Kosova duhet të përfshijë të gjitha rastet e nivelit të lartë për korrupsionin dhe krimin e organizuar në kuadër të bazës së të dhënave për monitorimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë të përzgjedhura në kontekstin e liberalizimit të vizave.<sup>28</sup> Në përgjithësi, do të jetë thelbësore të evidentohet progres i vazhdueshëm në raportin e Komisionit Evropian të vitit 2022 për të bindur shtetet anëtare të fokusuar në sundimin e ligjit si Holanda.

## Si perceptohet pozicioni holandez në Prishtinë

Ekziston një perceptim i përgjithshëm në Prishtinë se Holanda nuk ka një pozicion të qartë dhe specifik sa i përket kërkesave të saja për avancim të sundimit të ligjit, në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave. Sipas të intervistuarve për këtë hulumtim, Holanda ka ngritur shqetësime të përgjithshme për situatën e sundimit të ligjit në Kosovë, por asnjëherë nuk ka përcaktuar se cilat janë ato shqetësime konkretisht. Për më tepër, ata mendojnë se Holanda nuk është angazhuar kurrë seriozisht me Kosovën, as me Komisionin Evropian, për të diskutuar dhe trajtuar këto shqetësime. Një qëndrim i tillë shihet si sinjal i mungesës së interesit për të avancuar çështjen e liberalizimit të vizave. Në përgjithësi, zgjerimi nuk është një prioritet për Holandën dhe nuk gëzon mbështetje të gjerë publike.<sup>29</sup> Prandaj, zyrtarët kosovarë mendojnë se Holanda e keqpërdor liberalizimin e vizave për të aplikuar kushtëzime ndaj Kosovës, kushtëzimet të cilat në fakt duhet të ngritën në kuadër të procesit të zgjerimit

<sup>24</sup> Në kuadër të raportit [the Freedom House report of 2022](#), Kosova është vlerësuar me 37.5 nga 100 pikë sa i përket cilësisë së demokracisë (ka qenë 36.5 në 2021), ndërsa në [the Transparency International Corruption Index of 2021](#), Kosova është vlerësuar me 39 nga 100 pikë (ka qenë 36 në 2020).

<sup>25</sup> Rreth 1,600 qytetar të Kosovës kanë aplikuar për azil në BE në 2021. Kjo përbënë rënie prej 95% në krahasim me 2014, kur 34,100 Kosovar qytetarë aplikuan për azil. Shih Eurostat, [“First time asylum applicants to EU by citizens of CPC, 2014 and 2021”](#); Eurostat, [“Enlargement countries – statistics on migration, residence permits, citizenship and asylum”](#)

<sup>26</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021, fq. 23.

<sup>27</sup> Komisioni Evropian, [“Kosovo 2021 report”](#), SWD 292 final/2, tetor 19, 2021: 24.

<sup>28</sup> Psh. Komisioni Evropian, [“Kosovo 2021 Report”](#), SWD 292 final/2, October 19, 2021: 24

<sup>29</sup> [“Standard Eurobarometer 96 – Winter 2021-2022 – National reports Netherlands”](#): 13.

dhe jo procesit të liberalizimit vizave.<sup>30</sup> Sipas zyrtarëve kosovarë ekzistojnë katër karakteristika të cilat formësojnë pozicionin holandez.

Së pari, perceptimi se Holanda nuk ka pozicion të qartë dhe specifik sa i përket kërkesave të saja për avancim të sundimit të ligjit, në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave, përforcohet nga raportimi i zyrtarëve të qeverisë së Kosovës se autoritetet holandeze kanë përsëritur në vazhdimësi se Holanda nuk ka çështje bilaterale me Kosovën për liberalizimin e vizave dhe se do të shprehë qëndrimin e saj mbi këtë çështje nëse, dhe kur, kjo ngrihet brenda Këshillit.<sup>31</sup> Ky lloj perceptimi mbështetet edhe më tej nga fakti se Holanda nuk i ka shprehur asnjëherë zyrtarisht shqetësimet e tyre për sundimin e ligjit brenda Këshillit të BE-së.<sup>32</sup> Ky është një rast i qartë i dallimeve në qëndrimet në mes Kosovës dhe Holandës, ku me një anë Holanda e konsideron liberalizimin e vizave një proces ndërmjet BE-së dhe Kosovës, ndërsa Kosova e konsideron si çështje që duhet ngritur në nivel të dialogut bilateral diplomatik me shtetet anëtare të BE-së.

Së dyti, për shkak se holandezët asnjëherë nuk kanë specifikuar qartë se çfarë do të konsideronin ata përmbushje të kriterëve të liberalizimit të vizave, ekziston një perceptim i pashmangshëm i arbitraritetit në pozicionin holandez. Pala Kosovare e ka vështirë të kuptoj këtë qasje holandeze. Një mjedis i tillë i cili karakterizohet me paqartësi të pritjeve të palëve, si dhe mungesën e një procesi dialogues është terren shumë i përshtatshëm për lindjen e keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve.<sup>33</sup> Sipas zyrtarëve të Kosovës, kjo qasje holandeze vë në dyshim edhe gjithë punën e deri tanishme të Komisionit Evropian.

Së treti, fokusi holandez në qëndrueshmërinë e reformave nuk është pjesë e metodologjisë së liberalizimit të vizave. Në regjimin aktual të liberalizimit të vizave, qëndrueshmëria e reformave sigurohet nëpërmjet mekanizmit monitorues i cili ngritët pasi që një vend fillon të përfitojë nga procesi i liberalizimit të vizave. Rrjedhimisht, kjo ngre pikëpyetje mbi insistimin holandez në qëndrueshmërinë para vendimit për liberalizimin e vizave. Në Kosovë një qasje e tillë holandeze perceptohet si pasojë e përkeqësimit të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të BE-së dhe shteteve të saja anëtare, që nga ana tjetër mund të ndikojë negativisht në rolin dhe imazhin e institucioneve të BE-së në Kosovë.<sup>34</sup>

Së katërti, ndërsa vendet e tjera skeptike janë angazhuar në dialog të drejtpërdrejtë bilateral me autoritetet e Kosovës për të adresuar shqetësimet e tyre, pikëpamja holandeze ka qenë dhe mbetet se një dialog i tillë duhet të mbetet në nivel të BE-së.<sup>35</sup> Autoritetet kosovare kanë vlerësuar pozitivisht dialogun bilateral të ngritur me Francën dhe Gjermaninë, pasi që kjo reflektoj gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në zgjidhjen e shqetësimeve që kishin. Prandaj, ata e shohin refuzimin holandez për ngritjen e dialogut bilateral si pasojë e mungesës së vullnetit dhe arbitraritetit holandez në procesin e liberalizimit të vizave.<sup>36</sup>

Diskutimi mbi perspektivën holandeze tregon se ekzistojnë dy skenarë potencialë për përfundimin e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën: ose përparim në reformat e sundimit të ligjit ose një ndryshim i pozicionit të Francës dhe përsëritje e skenarit të 2010-ës. Në Prishtinë ka një pritje të përgjithshme se skenari në të cilin Franca ndryshon pozicionin

<sup>30</sup> Intervistë me anëtar të kabinetit politik, prill 2022, Prishtinë.

<sup>31</sup> Intervistë me zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës, maj 2022, Prishtinë.

<sup>32</sup> Intervistë me ish zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës, maj 2022, Prishtinë.

<sup>33</sup> Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, qershor 2022, Prishtinë.

<sup>34</sup> Në të vërtetë, shumë të intervistuar ndajnë pikëpamjen se dëshmimi i mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së kur bëhet fjalë për vlerësimin e progresit në liberalizimin e vizave ka ndikuar negativisht në besueshmërinë e Komisionit Evropian në Kosovë, si dhe në proceset që nuk lidhen drejtpërdrejt me liberalizimi i vizave.

<sup>35</sup> Madhi, 2021, 'Diluting Principles, Darkening EU Accession Perspective: Politicization of Kosovo's Visa Liberalization Process', in Armakolas et al (eds.), *Local and International Determinants of Kosovo's Statehood*: 316.

<sup>36</sup> Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, qershor 2022, Prishtinë.

e saj dhe holandezët izoloohen është skenar më real. Kjo tregon se përfaqësuesit kosovarë mendojnë se qëndrimi holandez nuk është aq teknik sa proklamohet, por është më shumë i ndikuar nga faktorët politikë.

Në përmbledhje, zyrtarët kosovarë e kanë vështirë të arsyetojnë pozicionin holandez për liberalizimin e vizave. Në sytë e tyre, rregullat e lojës për liberalizimin e vizave u vendosën në vitin 2012. Loja zgjati dhjetë vjet dhe në fund të lojës referi shpalli rezultatin: Kosova kishte përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave. Holanda ishte pajtuar me rregullat e lojës që nga fillimi dhe mori pjesë në të. Prandaj është e kuptueshme pse në Kosovë ndryshimi i rregullave të lojës në gjysmë të lojës, ose refuzimi për të pranuar rezultatin përfundimtar të lojës, perceptohet si jo fer.

## Përfundimet dhe rekomandimet

Intervistat e realizuara për këtë studim tregojnë se zyrtarët holandezë dhe kosovarë kanë qëndrime të ndryshme për procesin e liberalizimit të vizave. Qëndrimi i të dy palëve është i kuptueshëm. Nga njëra anë, ka kuptim që Holanda të përdor procesin e liberalizimit të vizave për të monitoruar progresin e reformave në Kosovë. Në anën tjetër, Kosova është në të drejtën e saj kur kërkon që i gjithë procesi të jetë sa më fer dhe të evitohen situatat ku palët perceptohen si arbitrare në qëndrimet e tyre.

Përkundër pozicioneve të ndryshme, përgjatë vitit të kaluar dhe këtë vit Kosova ka bërë përparim në fushën e sundimit të ligjit dhe sinjalet e fundit nga Holanda sugjerojnë se këto reformat janë duke u mirëpritur në Hagë. Si rezultat, mundësitë për tejkalimin e bllokimit janë në horizont, por në fund çdo gjë do të varet progresi i vazhdueshëm i Kosovës në fushën e sundimit të ligjit dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Raporti i ardhshëm i Komisionit Evropian për përmbushjen e kriterëve të liberalizimit të vizave do të jetë qenësor për ndryshimin e qëndrimit të vendeve skeptike, përfshirë Holandën. Po ashtu, duhet njohur se ekzistojnë edhe faktorë të jashtëm të cilët ndikojnë në vendimmarrjen e BE-së e të cilët janë jashtë kontrollit të Kosovës. Agresioni i paprovokuar rus mbi Ukrainën ka vënë në lëvizje pllakat tektonike gjeopolitike. Në këtë drejtim, Samiti i fundit Evropian (23-24 qershor 2022) ofroi një mbështetje të rëndësishme për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. Shumë liderë të BE-së u shprehën pro liberalizimit të vizave dhe për herë të parë askush nuk foli kundër. Prandaj, është e arsyeshme të pritët që liberalizimi i vizave për Kosovën do të mbështetet fuqishëm nga presidenca çeke e Këshillit të BE-së. Kjo mund të krijoj një mjedis inkurajues për vendimmarrje brenda Këshillit deri në fund të këtij viti. Në ndërkohë, ne rekomandojmë që Kosova dhe Holanda të angazhohen konstruktivisht në kuadër të aktiviteteve vijuese.

## Rekomandimet për Kosovën

E para, Kosova duhet të vazhdojë me reformat gjithëpërfshirëse në fushën e sundimit të ligjit, qeverisjes së mirë dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Siç u diskutua më lart, Haga është e inkurajuar nga zhvillimet e fundit në Kosovë dhe pret që Prishtina të vazhdojë me këto reformat. Zbatimi serioz i këtyre reformave është thelbësor për ndryshimin përfundimtar të pozicionit të Holandës.

E dyta, Kosova duhet të vazhdojë të zbatojë dhe raportojë për kriteret kyçe të liberalizimit të vizave. Është e rëndësishme që në koordinim të ngushtë me Komisionin, Kosova të raportojë rregullisht për progresin e bërë në zbatimin e vazhdueshëm të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Raporti vjetor i BE-së për Kosovën ka rekomanduar vazhdimisht që Kosova të zgjeroj bazën e të dhënave për monitorimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar me qëllim të përfshirjes të të gjitha rasteve të nivelit të lartë. Mos zbatimi i rekomandimeve të këtilla të Komisionit Evropian do hapin rrugë për dyshime dhe skepticism të vendeve anëtare të BE-së.

E treta, Kosova duhet të vazhdojë të përdorë të gjitha kanalet diplomatike në Prishtinë, Bruksel dhe kryeqytetet e vendeve anëtare të BE-së për t'i informuar rregullisht për progresin mujor që po bëhet në çështjet e lartpërmendura. Në Prishtinë, takimet e rregullta të Shefave të Misioneve të BE-së do të ishin ideale për shkëmbime të tilla mujore, ndërsa rrjetet diplomatike të Kosovës duhet të përsërisin të njëjtat mesazhe nëpër institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare.

Dhe e fundit, edhe pse dialogu me Serbinë nuk është një kërkesë formale për liberalizimin e vizave, në praktikë shumë shtete anëtare i shohin të ndërlidhura këto dy procese. Edhe pse këto janë procese të ndara, ato janë pjesë e rrugës integruese të Kosovës dhe rrjedhimisht çfarëdo ngecje në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve do të ketë pasoja edhe në procesin e liberalizimit të vizave.

## Rekomandimet për Holandën

Holanda do të duhej të vazhdojë të monitoroj në mënyrë rigoroze reformat në fushën e sundimit të ligjit dhe kriterëve të tjera për liberalizimin e vizave. Mirëpo ajo duhet të jetë e kujdesshme në insistimin për qëndrueshmërinë e reformave në periudhën e para liberalizimit të vizave, pasi që mënyra për të kërkuar qëndrueshmërinë e reformave është përmes mekanizmit monitorues pas ofrimit të liberalizimit të vizave të cilin e kanë në dispozicion institucionet e BE-së dhe vendet anëtare.

Për të sinjalizuar qasjen e saj konstruktive për liberalizimin e vizave Holanda mund të jetë më aktive në angazhimin bilateral për liberalizimin e vizave me Kosovën. Edhe pse holandezët nuk e shohin angazhimin bilateral si pjesë relevante e metodologjisë së liberalizimit të vizave, një angazhim i tillë do të adresonte perceptimet e holandezëve në Kosovë si të pavullnetshëm dhe të painteresuar për procesin e liberalizimit të vizave, gjë që ndikon negativisht në besueshmërinë holandeze dhe të BE-së në procesin e zgjerimit.



### **Për Institutin Clingendael**

Clingendael – Instituti Holandez për Marrëdhëniet Ndërkombëtare – është institut dhe akademi udhëheqëse për çështjet ndërkombëtare. Nëpërmjet analizave tona, trajnimeve dhe debatit publik ne synojmë të frymëzojmë dhe pajisim qeveritë, bizneset dhe shoqërinë civile me informatat dhe ekspertizën e nevojshme me qëllim të kontribuimit në ndërtimin e një bote të sigurt, të qëndrueshme dhe të drejtë.

### **Për Institutin EPIK**

Institute është think-tank i pavarur dhe jofitimprurës i politikave publike që bashkon një ekip të veçantë akademikësh dhe profesionistësh, me qëllim të mbështetjes së përpjekjeve për integrim evropian të Kosovës. Puna jonë bazohet në kapacitetet cilësore njerëzore, në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe Evropë, me qëllim të ofrimit të kontributit tonë në formimin e politikave alternative publike përmes kërkimeve, analizave dhe debateve të hapura dhe empirike.

### **Për autorët**

**Wouter Zweers** është hulumtues pranë Njesisë së Çështjeve Evropiane dhe Globale të Institutit Clingendael. Hulumtimi i tij është i përqendruar në dimensionin e jashtëm të politikëbërjes së BE-së me fokus të veçantë në Ballkanin Perëndimor dhe rajonet e Partneritetit Lindor. Ai koordinon 'Balkans Hub' në Clingendael, një projekt në të cilin Clingendael angazhohet me institutet hulumtuese nga Ballkani Perëndimor në studime dhe ngjarje të përbashkëta. Wouter ka vijuar studime themelore në Studime Evropiane nga Universiteti i Amsterdemit dhe studimet e magjistraturës në Menaxhim Publik Ndërkombëtar dhe Politika nga Universiteti Erasmus I Roterdamit.

**Luc Köbben** është Asistent Hulumtues pranë Njesisë së Çështjeve Evropiane dhe Globale të Institutit Clingendael, ku ai është i përqendruar në çështjet e brendshme të BE-së dhe zgjerimin e BE-së. Ai ka vijuar studime themelore në Histori nga Universiteti Leiden, studimet e magjistraturës në histori evropiane nga Universiteti Leiden, Panthéon-Sorbonne I dhe Universiteti i Oksfordit (Programi Europaeum), dhe Studimet e BE-së nga Universiteti Leiden.

**Arben Kalaja** është hulumtues në Institutin e Politikave Evropiane të Kosovës. Hulumtimi i tij fokusohet në Ballkanin Perëndimor dhe procesin e integritimit evropian të Kosovës, veçanërisht në fushat e administratës publike dhe çështjeve të brendshme. Arbeni ka vijuar studime themelore në shkenca politike nga Universiteti i Prishtinës dhe studimet e magjistraturës në Politikë Evropiane dhe Politika Publike në Universitetin e Mançesterit.

**Demush Shasha** është Drejtor Ekzekutiv në Institutin e Politikave Evropiane të Kosovës. Hulumtimi i tij fokusohet në Ballkanin Perëndimor dhe procesin e integritimit evropian të Kosovës. Ai ka studiuar administrim biznesi në Universitetin e Prishtinës dhe çështjet e BE-së në Kolegjin Evropian të Parmës.

*Mbështetur nga një grant nga Instituti i Fondacionit të Shoqërisë së Hapur në bashkëpunim me OSIFE të Fondacionit për Shoqëri të Hapur dhe Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur.*